



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO

Ac.nr.10037/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Burim Shala, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Bujar Muzaqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozueses Xh.R. nga P., të cilin e përfaqëson i autorizuari B.T. avokat nga P., kundër kundërshtarit të sigurimit S.R. nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson T.R. avokat nga P., me propozim për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës të propozueses Xh. R. nga P., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3235/2019, i datës 11.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.12.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa pathemeltë ankesa e propozueses Xh.R., nga P., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3235/2019, i datës 11.10.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar C.nr.3235/2019, të datës 11.10.2021, në pikën I (një) të dispozitivit e ka refuzuar propozimin e propozueses të sigurimit Xh.R. nga P., me të cilën ka kërkuar të caktohet masa e sigurisë dhe ti ndalohej kundërshtarit të sigurimit S. R. nga P., të tjetërsoj, fshehtë, ngarkoj apo disponoj me $\frac{1}{4}$ e pasurisë-paluarjtshmërisë në njësinë kadastrale ... e evidentuar në emër të kundër propozuesit sipas certifikatës pronësore ... ZK Prishtinë, ky ndalim të regjistrohet në regjistrin përkatës, ruajtja e pasurisë, në atë mënyrë duke i dorëzuar në posedim propozueses $\frac{1}{4}$ e paluarjtshmërisë dhe ta liroj lokalit nga sendet dhe njerëzit, t'ia kthej në posedim propozueses dhe në lidhje me këtë ta njoftoj propozuesen në afat optimal, si i pabazuar. Në pikën II (dy) të dispozitivit ka theksuar se pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, gjykata do ta obligoj arkën e kësaj gjykate që propozueses t'ia kthehet garancia e deponuar në shumë prej ... euro, e paguar sipas urdhërpagesës me datë Në pikën e III (tretë) të dispozitivit e ka detyruar propozuesen Xh. R. nga P., që kundër propozuesit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej ... euro, në afat prej 7 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi-plotfuqishmërisë, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktvendimi propozuesi, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, kundër aktvendimit C.nr. 3235/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë për shkak: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të se drejtës materiale me propozim që të caktohet masa e sigurimit dhe të ndryshohet aktvendimi i atakuar përmes kësaj ankese.

Po ashtu përgjigje në ankesë ka paraqitur kundërshtari i masës së sigurimit që gjykata ta refuzoj si të pathemeltë ankesën e përfaqësueses së propozuesit të masës së sigurimit dhe ta vërtetoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e propozueses, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 24.09.2019, ka paraqitur padi për caktimin e masës së sigurisë, me propozim për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar në baze të provave dhe fakteve ka ardhur në përfundim se, duke u bazuar në nenin 297 të LPK-së, në mënyrë decisive ceket se: “Masa e sigurimit mund të caktohen në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare e do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”, po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se, mes tjerash: “propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”.

Gjykata e Apelit e pranon qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje të thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar propozuesja e sigurimit.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të propozuesit të sigurimit për përfshirjen e aktvendimit të ankimuar me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktvendimit është i qartë i kuptueshëm dhe në harmoni me arsyetimin e aktvendimit, e rrjedhimisht

në arsyetimin e aktvendimit janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet që kanë qenë me ndikim për çështjen.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore propozueses së sigurimit se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se propozuesja është pronare e lokalit nr.8 me sipërfaqe prej ...m2 i cili është i ndërtuar në ngastrën kadastrale nr.... për Z.K. Prishtinë. Dhe për këtë sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk ekziston kurrfarë rreziku për tjetërsimin e tij nga kundërshtari i sigurimit Komuna e Prishtinës pasi që kjo nuk mund të bëhet për faktin se ajo nuk është e regjistruar si pronare këtij lokali. Sa i përket pjesës tjetër të sipërfaqes së lokalit më shumë se ... m2, propozuesja nuk ka ofruar prova për ta bërë të besueshme kërkesën a të drejtën subjektive të saj. Nga kontrata mbi shitblerjen e lokalit Vr.nr.... e datës, vërtetohet fakti se propozuesja e ka blerë lokalin me sipërfaqe prej 38 m2 dhe jo me sipërfaqe prej ... m2 ashtu siç kërkon ti caktohet masa e sigurimit të kërkesëpadsisë dhe mbi këtë bazë drejtë gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka vlerësuar se propozuesja për pjesën e lokalit më shumë se ...m2 nuk e ka bërë të besueshme të drejtën subjektive.

Janë të pabazuara pretendimet ankimore të propozueses së sigurimit se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit asaj mund ti shkaktohet dëm. Kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë se kundërshtari i sigurimit ka ndërmarr veprime në drejtim të cenimit apo të rrezikimit të lokalit nr.8.

Nga te cekurat me lartë, e ne mbështetje te dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10037/21, datë 15.12.2021

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,
Burim Shala, d.v